



Datë: 21.07.2025
Numër Protokolli: 5019/2025

A.nr.1937/2024

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës–Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Eshref Shabani-Kryetar, Ardita Haxhnikaj Demi dhe Malsore Gashi Bajraktari–anëtarë, me Sabile Avdyli-Zyrtare e Lartë për Inspektim Administrativ, në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.1937/2024 të datës 13.12.2024 të parashtruar nga ankuesit/et : S.S, M.M, N.D, N.G, I.M, F.J, I.S, M.R, S.S, A.M, J.B, E.F, Y.S, V.G, E.I, B.K, F.D, N.R, I.A, S.Y, M.M, A.A, M.O, L.G, D.B, G.L, S.M, E.H, S.G, S.S, R.H, M.M, D.G, L.G, A.M, A.V, B.G, T.S, O.S, V.D, M.D, L.A, F.P, S.G, P.J, A.I, D.L, E.J, E.B, S.S, D.M, X.N, M.S, B.B, të cilët i përfaqëson sipas autorizimit avokati Armend Deskaj, kundër organit të punësimit Kuvendi i Republikës së Kosovës, në çështjen juridike “*Kompensim material*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datën 21.07.2025, mori këtë:

V E N D I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa A.nr.1937/2024 të datës 13.12.2024 të ankuesve S.S, M.M, N.D, N.G, I.M, F.J, I.S, M.R, S.S, A.M, J.B, E.F, Y.S, V.G, E.I, B.K, F.D, N.R, I.A, S.Y, M.M, A.A, M.O, L.G, D.B, G.L, S.M, E.H, S.G, S.S, R.H, M.M, D.G, L.G, A.M, A.V, B.G, T.S, O.S, V.D, M.D, L.A, F.P, S.G, P.J, A.I, D.L, E.J, E.B, S.S, D.M, X.N, M.S, B.B.

A r s y e t i m

Ankuesit S.S, M.M, N.D, N.G, I.M, F.J, I.S, M.R, S.S, A.M, J.B, E.F, Y.S, V.G, E.I, B.K, F.D, N.R, I.A, S.Y, M.M, A.A, M.O, L.G, D.B, G.L, S.M, E.H, S.G, S.S, R.H, M.M, D.G, L.G, A.M, A.V, B.G, T.S, O.S, V.D, M.D, L.A, F.P, S.G, P.J, A.I, D.L, E.J, E.B, S.S, D.M, X.N, M.S, B.B (*tutje referuar vetëm ankuesit*), më datë 30.10.2024 përmes përfaqësuesit të autorizuar avokatit Armend Deskaj kanë parashtruar ankesë me numër protokolli 6725/24 për kompensimin ditorë në shumë prej 5(pesë) euro për periudhën janar-tetor 2024 të punësuarëve në Kuvendin e Republikës së Kosovës sipas Rregullores Nr.08-008 për Shtesa dhe Kompensimin mbi Pagën Bazë të Nëpunësve Civil të Administratës së Kuvendit të Kosovës e miratuar me Nr.08-V-509, të datës 05.06.2023.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregullores Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 14.05.2024 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Kuvendi i Republikës së Kosovës, ndërsa Këshilli më datë 14.01.2025, ka pranuar përgjigje në ankesë nga Kuvendi i Republikës së Kosovës, me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me datë 17.03.2025 me vendimin A.nr.1937/2024 ka pezulluar procedurën administrative të nisur sipas ankesës A.nr.1937/2024 të datës 13.12.2024 sepse Nga shkresat e lëndës, Kolegji i këshillit ka gjetur se njëri prej ankuesve Osman Shatri sipas Akt Emërimit me numër AE.Nr.325/2027, të datës 10.10.2023, është i punësuar në pozitën e punës “Zyrtar i Lartë Ligjor”, në Kuvendin e Republikës së Kosovës. më datë 05.02.2024, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, lidhur me mos kompensimin ditor në vlerë prej pesë (5), për periudhën janar 2024.

Me qëllim të shqyrtimit të ligjshmërisë së pretendimeve ankimore të ankuesve si dhe konstatimit të gjendjes faktike ndërlidhur me ankesën e ankuesve të datës 13.12.2024, Këshilli me datë 21.02.2024 përmes E-mailit i është drejtuar Referentit të Lartë F.ZH në Gjykatën Themelore në Prishtinë nga i cili kemi kërkuar një kopje të padisë të parashtruar nga z. Osman Shatri kundër Vendimit të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës A.nr.170/2024 të datës 04.04.2024, I njëjti me të njëjtën datë na ka dërguar përmes E-mailit Kopjen e Përgjigjes në Padi A.nr.2694/2024 të datës 28.06.2024 të parashtruar në Gjykatën Themelore në Prishtinë përmes përfaqësuesit të autorizuar avokatit Armend Deskaj.

Përfaqësuesi i autorizuar i ankuesve avokati Armend Deskaj me datë 20.05.2025 ka kërkuar nga Këshilli që të rihapet procedura pran Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës sipas ankesës A.nr.1937/24 të datës 13.12.2024 sepse i njëjti me datën 28.04.2025 ka paraqitur parashtresën për tërheqjen e padisë A.nr.2694/24. është Gjykata Themelore në Prishtinë – Departamenti për ÇAdministrative me Aktvendimin A.nr.2694 e datës 12.05.2025, ka hapur rrugë që Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës i Kosovës për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës që ta shqyrtojë ankesën A.nr.1937/2024 të datës 13.12.2024.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokolli 6725/2024 të datës 13.12.2024 të parashtruar nga ankuesit në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Autorizimi me nr.03/24 i datës 19.06.2024; Akt Emërimi A.E.Nr.261/2012 i datës 10.10.2023; Akt Emërimi A.E.Nr.187/2010 i datës 10.10.2023; Akt Emërimi A.E.Nr.026/2001 i datës 10.10.2023 ; Akt Emërimi A.E.Nr.012/2009 i datës 10.10.2023; Akt Emërimi A.E.Nr.180/2009 i datës 10.10.2023; Akt Emërimi A.E.Nr.302/2015 i datës 10.10.2023; Akt Emërimi A.E.Nr.217/2018 i datës 10.10.2023; Akt Emërimi A.E.Nr.308/2016 i datës 10.10.2023; Akt Emërimi A.E.Nr.214/2011 i datës 10.10.2023; Akt Emërimi A.E.Nr.345/2019 i datës 10.10.2023; Akt Emërimi A.E.Nr.344/2019 i datës 10.10.2023 ; Akt Emërimi A.E.Nr.344/2019 i datës 10.10.2023; Akt Emërimi A.E.Nr.113/2001 i datës 10.10.2023 ; Akt Emërimi A.E.Nr.188/2010 i datës 10.10.2023 ; Akt Emërimi A.E.Nr.098/2005 i datës 10.10.2023; Akt Emërimi A.E.Nr.019/2007 i datës 10.10.2023; Akt Emërimi A.E.Nr.132/2002 i datës 10.10.2023; Akt Emërimi A.E.Nr.265/2012 i datës 10.10.2023; Akt Emërimi A.E.Nr.072/2001 i datës 10.10.2023; Akt Emërimi A.E.Nr.104/2001 i datës 10.10.2023 ; Akt Emërimi A.E.Nr.128/2002 i datës 10.10.2023; Akt Emërimi A.E.Nr.035/2009 i datës 10.10.2023; Akt Emërimi A.E.Nr.120/2001 i datës 10.10.2023 ; Akt Emërimi A.E.Nr.062/2007 i datës 10.10.2023; Akt Emërimi A.E.Nr.020/2007 i datës 10.10.2023 ; Akt Emërimi A.E.Nr.333/2019 i datës 10.10.2023; Vendimi me Nr.05/24 i datës 12.01.2018 i Qeverisë së Republikës së Kosovës; Akt Emërimi A.E.Nr.085/2002 i datës 10.10.2023; Akt Emërimi A.E.Nr.348/2020 i datës 10.10.2023 ; Akt Emërimi A.E.Nr.346/2020 i datës 10.10.2023; Akt Emërimi A.E.Nr.116/2001 i datës 10.10.2023 ; Akt Emërimi A.E.Nr.307/2016 i datës 10.10.2023 ; Akt Emërimi A.E.Nr.017/2002 i datës 10.10.2023; Akt Emërimi A.E.Nr.104/2001 i datës 10.10.2023; Akt Emërimi A.E.Nr.066/2001 i datës 10.10.2023 për R.H; Akt Emërimi A.E.Nr.142/2002 i datës 10.10.2023; Akt Emërimi A.E.Nr.312/2016 i datës 10.10.2023; Akt Emërimi A.E.Nr.115/2001 i datës 10.10.2023; Akt

Emërimi A.E.Nr.320/2017 i datës 10.10.2023; Akt Emërimi A.E.Nr.326/2018 i datës 10.10.2023; Akt Emërimi A.E.Nr.263/2012 i datës 10.10.2023; Akt Emërimi A.E.Nr.038/2007 i datës 10.10.2023; Akt Emërimi A.E.Nr.325/2017 i datës 10.10.2023; Akt Emërimi A.E.Nr.220/2012 i datës 10.10.2023; Akt Emërimi A.E.Nr.207/2011 i datës 10.10.2023; Akt Emërimi A.E.Nr.097/2005 i datës 10.10.2023; Akt Emërimi A.E.Nr.270/2012 i datës 10.10.2023; Akt Emërimi A.E.Nr.189/2010 i datës 10.10.2023; Akt Emërimi A.E.Nr.130/2002 i datës 10.10.2023; Akt Emërimi A.E.Nr.060/2007 i datës 10.10.2023; Akt Emërimi A.E.Nr.213/2001 i datës 10.10.2023 ; Akt Emërimi A.E.Nr.318/2016 i datës 10.10.2023; Akt Emërimi A.E.Nr.315/2001 i datës 10.10.2023; Akt Emërimi A.E.Nr.330/2018 i datës 10.10.2023; Akt Emërimi A.E.Nr.216/2011 i datës 10.10.2023; Akt Emërimi A.E.Nr.211/2018 i datës 10.10.2023 ; Akt Emërimi A.E.Nr.220/2014 i datës 10.10.2023; Akt Emërimi A.E.Nr.032/2001 i datës 10.10.2023 ; Akt Emërimi A.E.Nr.333/2019 i datës 10.10.2023; Kërkesa e datës 29.10.2024 ; Plotësimi i kërkesës i datës 05.11.2024; Vendimi i datës 14.06.2023 i Kryetarit të Kuvendit të Republikës së Kosovës; Përgjigje në kërkesë e datës 08.11.2024 nga Zëvendësuesi i Sekretarit të Përgjithshëm të Kuvendit të Republikës së Kosovës; E-mail zyrtar i datës 04.03.2024; E-mail i datës 27.02.2024; E-mail i datës 29.01.2024; E-mail i datës 26.01.2024; E-mail i datës ; E-mail i datës 15.01.2024; E-mail i datës 14.02.2024; E-mail i datës 15.03.2024; E-mail i datës 15.04.2024; E-mail i datës 15.05.2024; E-mail i datës 14.06.2024; E-mail i datës 15.07.2024; E-mail i datës 15.08.2024; E-mail i datës 12.09.2024; E-mail i datës 15.10.2024; Vendimi i datës 05.05.2023 i Kryetarit të Kuvendit të Republikës së Kosovës; Kërkesa për përgjigje në ankesë e datës 31.12.2024; Përgjigje në ankesë e datës 14.01.2025 nga organi i punësimit bashkë me shkresat e lëndës dhe Vendimi A.nr.609/2023 i datës 01.06.2023 me numër protokolli 4570/2023 i KPMSHCK-së; Kërkesa e datës 20.05.2025 për rihapjen e procedurës dhe Aktvendimi A.nr.2694/24 i datës 12.05.2025 i Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti për Çështje Administrative.

Kolegji i Këshillit duke u bazuar në vlerësimin e hollësishëm të çdo prove veç e veç dhe të gjitha provave të marra së bashku, si dhe bazuar në rezultatin tërësor të shqyrtimit administrativ, konstatoi së janë të pa bazuara pretendimet ankimore të ankuesve, *sepse*:

Kolegji i Këshillit nga shkresat e administruara të lëndës ka gjetur se ankuesi sipas Akt Emërimeve, janë të punësuar në Kuvendin e Republikës së Kosovës.

Ankuesit në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, pretendojnë për kompensimin ditor në shumë prej 5(pesë) euro për periudhën janar-tetor 2024 nuk është kompensuar sikurse muajve të tjerë, ngase nuk është llogaritur kompensimin prej pesë (5) euro për ditë pune në emër të kompensimit të paraparë me Rregulloren Nr.08-Rr-008 për Shtesat dhe Kompensimit mbi Pagën Bazë të Nëpunësve Civil të Administratës së Kuvendit të Republikë së Kosovës.

Njësia e Burimeve Njerëzore të Kuvendit të Kosovës, në përgjigjen në ankesë ka deklaruar se me datë 15.01.2024, i janë drejtuar me kërkesë Thesarit të Kosovës, për kompensimin e shumë prej 5 euro për ditë pune për gjithë të punësuarit e administratës të Kuvendit të Kosovës, për muajin Janar 2024, duke u bazuar kështu në dispozitat e Rregullores Nr.08-Rr-008 për shtesat dhe kompensimet mbi pagën bazë të nëpunësve civile të administratës së Kuvendit të Republikës së Kosovës, ndërsa Zëvendësdrejtori i Thesarit të Kosovës, me datë 29.01.2024 ka njoftuar zyrtaret përgjegjës të administratës së Kuvendit të Kosovës, se lidhur me këtë çështje i janë drejtuar për interpretim Departamentit Ligjor të Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve, dhe se pas pranimit të opinionit ligjor do t'i njoftoj të njëjtit, për veprimet e mëtutjeshme, edhe pse sipas shkresave të lëndës

rezulton se i njëjti organ nuk ka ndërmarr veprime për ekzekutimin e pagesës prej pesë (5) euro për të punësuarit e administratës së Kuvendit, ku janë përfshirë edhe ankuesi.

Kolegji i Këshillit lidhur statusin e të punësuarve të administratës së Kuvendit të Republikës së Kosovës, ju referua dispozitave të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyratet Publikë, gjegjësisht:

Nenit 1 [Qëllimi] ku përcaktohet se: *Ky ligj ka për qëllim rregullimin e marrëdhënies së punës së zyrtares/it publik në institucionet e Republikës së Kosovës, përkatësisht përcaktimin e rregullave dhe parimeve që rregullojnë pranimin, klasifikimin e pozitave, ndryshimin, përfundimin e marrëdhënies së punës, të drejtat dhe detyrimet në raport me marrëdhënien e punës, si dhe çështjet tjera që kanë të bëjnë me marrëdhënien e punës së zyrtares/it publik në institucionet e Republikës së Kosovës.*

Nenit 5 [Kategoritë e zyrtares/it publik] ku përcaktohet se: *1. Kategoritë e zyrtares/it publik janë: 1.1. Nëpunësja/i i shërbimit civil; 1.2. Nëpunësja/i i shërbimit publik; 1.3. Krijuesja/i dhe performuesja/i e/i artit dhe kulturës; 1.4. Nëpunësja/i teknik dhe mbështetës; dhe 1.5. Zyrtarja/i i kabinetit.*

Nenit 6 [Nëpunësja/i civil me status të veçantë] paragrafi 4 ku përcaktohet se: *4. Të punësuarat/it e administratës në kuadër të sistemit të drejtësisë, Gjykatës Kushtetuese, Presidencës, **Kuvendit të Republikës së Kosovës**, si dhe institucioneve të pavarura kushtetuese janë nëpunës civil me status të veçantë, rregullimi i të cilëve bëhet me akt të veçantë.*

Rrjedhimisht, bazuar në kuadrin përkatës ligjor, Kolegji konstatoi se të punësuarit e administratës së Kuvendit të Republikës së Kosovës, janë nëpunës civil me status të veçantë, rregullimi i të cilëve bëhet me akt të veçantë.

Ndërsa, lidhur me çështjen e pagave dhe kompensimeve të zyrtarëve publik, respektivisht nëpunësve civil, si dhe me qëllim të shqyrtimit të pretendimeve ankimore të ankuesit, Kolegji i Këshillit, ju referua dispozitave të Ligjit Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publikë, gjegjësisht:

Nenit 1 [Qëllimi] ku përcaktohet se: *1. Qëllimi i këtij ligji është që të krijojë një sistem të njëtrajtshëm të pagave në sektorin publik që përfshin parimet dhe rregullat për përcaktim të pagës në sektorin publik si dhe të krijojë një sistem të pagave dhe shpërblimeve, transparent dhe të menaxhueshëm ku elementi kryesor është paga bazë.*

Nenit 2 [Fushëveprimi] paragrafi 1 dhe 3 ku përcaktohet se: *1. Ky ligj zbatohet për të punësuarat/it në sektorin publik pagat e të cilave/ëve financohen nga dhe përmes buxhetit të shtetit, përjashtimisht Agjencisë Kosovare për Inteligjencë. 3. Për nëpunëset/it në Presidencën e Republikës së Kosovës, Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Sistemin e Drejtësisë, **Kuvendin e Republikës së Kosovës**, dhe institucionet e pavarura kushtetuese, ky ligj zbatohet për aq sa nuk cenon pavarësinë e tyre funksionale dhe organizative të garantuar me Kushtetutë”.*

Nenit 13 [Paga e nëpunëses/it civil] përcakton: *“Paga e nëpunëses/it civile përbëhet nga **paga bazë, shtesat dhe kompensimet**, kur shtesat dhe kompensimet janë të aplikueshme sipas këtij ligji”.*

Nenit 22 [Shtesa] paragrafi 1 dhe 2 ku përcaktohet se: *1. Shtesat që mund përfitohen në bazë të këtij ligji janë: 1.1. shtesa e veçantë për të zgjedhurat/it; 1.2. shtesa për kushte tregu të punës; 1.3. shtesa e performancës; 1.4. shtesa për kushte specifike të punës; 1.5. shtesa për punën pa orar të*

*paracaktuar; 1.6. shitesa për vëllimin e punës; 1.7. shitesa për licencë të avancuar për nëpunësen/in e arsimit para universitar; 1.8. shitesa për nëpunësen/in e sistemit shëndetësor; 1.9. shitesa e performancës për krijuesen/in dhe performuesen/in e artit dhe kulturës; 1.10. shitesa funksionale. 2. Shtesa dhe kompensimi i nëpunëses/it në Presidencën e Republikës së Kosovës, Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Sistemin e Drejtësisë, Kuvendin e Republikës së Kosovës, dhe institucionet e pavarura kushtetuese rregullohen **me këtë ligj dhe me akt të veçantë të miratuar nga organet kompetente të institucionit përkatës**”.*

Në këndvështrim të dispozitave të ligjit përkatës për Pagat në Sektorin Publikë, Kolegji konstaton se, shitesat që mund përfitohen nga nëpunësit civil janë të specifikuara me nenin 22 të këtij ligji, ndërsa shitesat dhe kompensimi i nëpunësve civil në Presidencën e Republikës së Kosovës, Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Sistemin e Drejtësisë, **Kuvendin e Republikës së Kosovës**, dhe institucionet e pavarura kushtetuese, rregullohen me ligjin përkatës për Pagat në Sektorin Publik dhe me akte të veçanta të miratuar nga organet kompetente të institucioneve përkatëse kushtetuese.

Si rrjedhojë, në kontekst të aplikimit të akteve të veçantë të miratuar nga organet kompetente të institucioneve përkatëse, të themeluara me Kushtetutë, Kolegji i Këshillit, ju referua Aktgjykimin të Gjykatës Kushtetuese në rastin nr. KO79/23 për Vlerësimin e kushtetutshmërisë së Ligjit Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, gjegjësisht pikës IX. të dispozitivit, ku përcaktohet se: *TE KONSTATOJE se deri në plotësimin dhe ndryshimin e paragrafit 2 të nenit 2 (Fushëveprimi) të Ligjit nr. 08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik nga Kuvendi i Republikës së Kosovës, paragrafi 3 i nenit 2 (Fushëveprimi), **paragrafi 2 i nenit 22 (Shtesat)**, paragrafi 5 i nenit 24 (Shtesa për kushte të tregut të punës), paragrafi 8 i nenit 25 (Shtesa e performancës), paragrafi 7 i nenit 28 (Shtesa për vëllimin e punës) dhe paragrafi 4 i nenit 42 (Përcaktimi i ekuivalencës) **te zbatohen në përputhje me Kushtetutën dhe këtë Aktgjykim...***” rrejdhimisht në ndërlidhje me këtë konstatim Kolegji mori parasysh edhe paragrafët:

- **Paragrafi 280:** “Gjykata rikujton edhe një herë që qëllimi i Ligjit të kontestuar është që të krijojë një sistem të njëtrajtshëm të pagave në sektorin publik që përfshin parimet dhe rregullat për përcaktim të pagës në sektorin publik. Ndër të tjera, i njëjti gjithashtu përcakton se (i) zbatohet për të punësuarat/it në sektorin publik pagat e të cilëve financohen nga dhe përmes buxhetit të shtetit, përjashtimisht Agjencisë Kosovare për Inteligjencë; dhe (ii) që rregullat dhe kushtet për përcaktimin e pagës të të punësuarve në sektorin publik janë ekskluzivisht rregullim i këtij ligji dhe “mund të rregullohen edhe me akte të tjera nënligjore, vetëm kur parashihet shprehimisht nga ky ligj”. Në kontekst, të nëpunësve në (i) Presidencën e Republikës së Kosovës; (ii) Gjykatën Kushtetuese; (iii) Sistemin e Drejtësisë; (iv) Kuvendin e Republikës së Kosovës; dhe (v) institucionet e pavarura kushtetuese, Ligji i kontestuar saktëson që i njëjti “zbatohet për aq sa nuk cenon pavarësinë e tyre funksionale dhe organizative të garantuar me Kushtetutë.”

-**Paragrafi 281** “Siç është shtjelluar më lart, nenet e lartcekura në parim përcaktojnë kushtet nën të cilat shitesat përkatëse mund të akordohen dhe tavanet përkatëse buxhetore. Këto të fundit, me përjashtim të pagës për funksion shtesë sipas nenit 8 (Llogaritja e pagës në raste të funksionit shtesë) të Ligjit të kontestuar, kanë vlerën prej zero pikë një përqind (0.1%) deri në zero pikë pesë përqind (0.5 %) të fondeve totale të përdorura për pagën bazë të zyrtarëve publikë të organizatës buxhetore në të njëjtin vit financiar (fiskal), për qëllime të së cilës, Qeveria e Republikës së Kosovës do të trajtohet si një (1) organizatë buxhetore. Për dallim, në kontekst të deputetëve të Kuvendit dhe/ose anëtarëve të Kuvendeve Komunale, mundësia e shtesave përkatëse është përcaktuar në vlerën prej

tridhjetë përqind (30%), bazuar në nenin 23 (Shtesa e veçantë për të zgjedhurat/it) të Ligjit të kontestuar”.

-Paragrafi 282. Gjykata vëren se Ligji i kontestuar përveç që përcakton mundësinë e përfitimit të shtesave respektive, përmban edhe tavane buxhetore të fondeve të cilat mund të përdoren për këto shtesa, duke paraparë kufizimin në përqindje të fondeve totale të përdorura nga institucioni për pagën bazë të zyrtarëve në të njëjtin vit financiar. Gjykata konsideron se të përcaktuarit e tavaneve buxhetore për kategori të caktuar të shtesave, në parim, ndjek një qëllim legjitim. Mirëpo, gjithashtu thekson që është thelbësore që përqindja e përcaktuar të ketë vlerë domethënëse për institucionin në fjalë, në mënyrë që të mundësohet edhe përmbushja e qëllimit të dispozitës ligjore. Në kontekst të kushtëzimit të tavaneve buxhetore me vlerën e fondeve totale të përdorura nga institucioni për pagën bazë të zyrtarëve në të njëjtin vit fiskal, Gjykata vlerëson se përcaktueset për përmbushjen e qëllimit të normave që përcaktojnë shtesa, është tërësia e fondeve për pagën bazë me të cilat disponon institucioni përkatës. Në kontekst të rregullimit ligjor që për qëllime të tavaneve buxhetore për shtesa, Qeveria do të trajtohet si një (1) organizatë buxhetore dhe duke marrë parasysh që fondet e tërësishme që e njëjta i disponon janë pakrahasimit më të favorshme sesa ato të institucioneve të pavarura kushtetuese, Gjykata nuk mund të mos vënë në pah që Qeveria vihet në pozitë 80 diametralisht më të favorshme krahasuar me institucionet tjera, në kuptim të shumës së disponueshme të cilën mund të e përdorë për shtesa, dhe të cilat për institucionet e pavarura kushtetuese janë të kufizuara nga zero pikë një përqind (0.1%) deri në zero pikë pesë përqind (0.5%) të fondeve totale të përdorura për pagën bazë të zyrtarëve në të njëjtin vit fiskal e të cilat, sigurisht operojnë me buxhete pakrahasimisht më të ulëta.

-Paragrafi 285 Në kontekst të sqarimeve të lartcekura, dhe përderisa paragrafi 3 i nenit 2 (Fushëveprimi) të Ligjit të kontestuar saktëson që përkitazi me institucionet e lartcekura, Ligji i kontestuar “zbatohet për aq sa nuk cenon pavarësinë e tyre funksionale dhe organizative të garantuar me Kushtetutë”, i njëjti në paragrafin 2 të nenit 2 të tij, saktëson që rregullat dhe kushtet për përcaktimin e pagës të të punësuarve në sektorin publik “janë ekskluzivisht rregullim i këtij ligji dhe mund të rregullohen edhe me akte të tjera nënligjore, vetëm kur parashihet shprehimisht nga ky ligj”, ndërsa ky i fundit, u përcakton të njëjtave institucione mundësinë e rregullimit të mëtejshëm të shtesave, kompensimeve dhe përcaktimit të ekuivalencës, përmes akteve të veçanta “të miratuara nga organet kompetente të institucioneve”. Këto të fundit janë akte nënligjore. Të njëjtat bazuar në parimin e hierarkisë së normave, duhet të jenë në përputhje me ligjin, dhe në kuptim të formulimit të paragrafëve përkatës të Ligjit të kontestuar, duhet të jenë në përputhje me Ligjin e kontestuar. Për më tepër, paragrafi 2 i nenit 45 (Shfuqizimi) të Ligjit të kontestuar, përcakton që “me hyrje në fuqi të këtij ligji shfuqizohet gjithashtu çdo dispozitë e ligjit apo e aktit nënligjor tjetër që rregullon çështjen e pagës, kompensimeve, shtesave, shpërblimeve apo kategorie tjetër në fushën e pagave, e që nuk është autorizuar shprehimisht për t’u nxjerr nga dispozitat e këtij ligji”, duke shfuqizuar jo vetëm dispozitat përkatëse të ligjeve të veçanta të institucioneve të pavarura kushtetuese të miratuara nga Kuvendi, por edhe aktet nënligjore të institucioneve të pavarura kushtetuese. Rrjedhimisht, këto të fundit, kanë autorizimin që me akte të veçanta, përkatësisht akte nënligjore, të përcaktojnë procedurat në zbatim të Ligjit të kontestuar, por gjithnjë nën kufizimet që i përcakton i njëjti ligj përfshirë (i) kushtet nën të cilat mund të përcaktohen shtesa; (ii) kufizimin e shtesave të tilla, përkatësisht prej zero pikë një përqind (0.1%) deri në zero pikë pesë përqind (0.5%) të fondeve totale të përdorura për pagën bazë të zyrtarëve publik për një vit financiar të 81 institucionit

përkatës; dhe (iii) për çdo ndryshimin në strukturën e tyre, përfshirë “krijimi i funksioneve, pozitive, apo emërtesave të reja”, i nënshtrohen miratimit të Qeverisë.

Rrjedhimisht, Kolegji i Këshilli nga analizimi i Aktgjykimit në rastin nr. KO79/23, thekson tani me faktin e pa kontestuar së Presidenca e Republikës së Kosovës; Gjykata Kushtetuese; Sistemi i Drejtësisë; Kuvend i Republikës së Kosovës; dhe institucionet e pavarura kushtetuese, kanë të drejtë dhe mundësinë e rregullimit të mëtejshëm të shtesave përmes akteve të veçanta të miratuara nga organet kompetente të institucioneve, mirëpo, duke qenë se Gjykata Kushtetuese ka detyruar Kuvendin që të plotësojë dhe ndryshojë paragrafin 2 të nenit 22 (shtesat) të Ligjit të kontestuar, duke ua mundësuar institucioneve të lartcekura që në përmbushje të garancive kushtetuese për pavarësinë e tyre, të funksionojnë edhe përmes ligjeve organike të veçanta, në pajtim me Kushtetutën dhe këtë Aktgjykim, atëherë, në vlerësimin e shumicës së Kolegjit institucionet e numëruar si në paragrafin 2 të Ligjit Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, shtesat e përcaktuara me nenin 22 paragrafi 1 të këtij ligji, mund ti rregullojnë në mënyrë të pavarur me akte të brendshme, duke u bazuar në specifikat e fushëveprimit të tyre, po assesi të përcaktojnë shtesa dhe kompensime përtej Ligjit bazik për paga, pasi që sikurse është theksuar nga Gjykata Kushtetuese përmes paragrafit 285 të aktgjykimit në rastin nr. KO79/2, aktet e brendshme nënligjore bazuar në parimin e hierarkisë së normave juridike duhet të jenë në pajtim me ligjin nga i cili buron e drejta e nxjerrjes së akteve nënligjore.

Marrë parasysh objektin e ankesës, Kolegji i Këshillit, në kontekst të çështjes, se parashtruar për shqyrtim, ka analizuar shkresat e lëndës dhe për rrjedhojë ka gjetur se Kryesia e Kuvendit të Kosovës, me datë 05.06.2023, me Vendimin Nr.08-V-509,ka miratuar Rregulloren Nr.08-Rr-008 për Shtesat dhe Kompensimet mbi Pagën Bazë të Nëpunësve Civile të Administratës së Kuvendit të Republikës së Kosovës. Rrjedhimisht sipas nenit 4 paragrafi 1 dhe 2, të kësaj rregullore përcaktohet se: ***1. Shtesa mbi pagën bazë i takon nëpunësit të Administratës së Kuvendit, bazuar në natyrën specifike të punës së Administratës së Kuvendit në mbështetje të punës së trupave punues të Kuvendit, që kërkon funksionimin efektiv të të gjitha shërbimeve në kohë dhe me përgjegjësi, pune nën presion kohor, pune me orar të zgjatur dhe të paparashikuar, si dhe kufizim në shfrytëzimin e pauzës ditore dhe të pushimit vjetor, për angazhim shtesë në vlerë prej 30% të pagës bazë. 2. Nëpunësi civil i Administratës së Kuvendit ka të drejtë në kompensimin ditor në vlerë 5 (pesë) euro për ditë pune.***

Andaj, bazuar në sqarimet e dhëna si me sipër, Kolegji i Këshillit konstaton se pretendimi ankimor i ankuesit i parashtruar sikurse në ankesë, për realizimin e kompensimit ditor si pagese shtesë mbi pagën bazë, në vlerë prej pesë (5) euro për ditë pune, në kuptim të se drejtës individuale është i pabazuar pasi që siç u konstatua me lart një shtesë të tillë nuk është e përcaktuar me nenin 22 paragrafi 1 të Ligjit Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik.

Kështu që, për sa me sipër dhe duke u bazuar në nenin 6 paragrafi 1, nën paragrafi 1.1, nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe nenin 132 paragrafi 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi. ***Këshillë juridike:*** Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit. Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë -Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda, A.nr.1937/2024

Sabile AVDYLI

Procesmbajtëse

Eshref Shabani

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Përfaqësuesit të autorizuar avokati Armend Deskaj;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore dhe Zëvendësuesit të Sekretarit të Përgjithshëm në Kuvendin e Republikës së Kosovës; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së